




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	2-0/DPK
Nr. I faq. Broj stranica Nr. pages	02
Nr. Prot. Br. Prot. Prot No.	01-3932/15
Data Datum Date	05-11-2015
PRISTINE	



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE  
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 24 paragrafi 11 dhe 12 të Rregullorës së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 05.11.2015, nxjerr këtë:

### V E N D I M

**I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-02-2947-15 për z.Nexhat Jashari–Drejtor i Administratës në Kuvendin e Kosovës, për shkak se është shmangur situata e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, meqë z.Jashari ka heq dorë nga funksioni i personit të autorizuar në një biznes privat (shuarje e biznesit), duke shmangur konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

### A r s y e t i m

**I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, me nr. AKK-03-02-2947-15, për Zyrtarin e lartë, z. Nexhat Jashari–Kuvendi i Kosovës, dhe njëkohësisht person i autorizuar në biznesin privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).**

Zyrtari i lartë, z. Jashari është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, pas të cilës ai është kontaktuar nga zyrtarët e Agjencisë kundër Korrupsionit, me ç'rast është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet, si dhe me ndryshimet që duhet të bëjë, për të shmangur situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

Zyrtari i lartë, z.Jashari, është deklaruar se do t'i bëjë ndryshimet e kërkuara në Agjencionin për regjistrimin e Bizneseve të Kosovës.

Ndërkohë, ai, në Agjencinë kundër Korrupsionit, ka sjell shkresën “Vërtetim Tatimor” (Dpk-Dpki-03-02-3857-15) nga Administrata Tatimore e Kosovës bashkë me pasqyrën e tatimeve dhe kontributeve (Dpk-Dpki-03-02-3656/15) , e pastaj edhe shkresën zyrtare nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK) “Njoftim për shuarje”(DPK/DPKI-03-02-



3891/15), në të cilën shihet se biznesi N.T.P. "Blerimi" tashmë është shuar në mënyrë vullnetare, me çka z.Jashari ka shmangur konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit



/Hasan Preteni /